



Datë: 19.03.2025
Numër Protokolli: 2203/2025

A.nr.150/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.150/2025, të datës, 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesja A.B, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.03.2025, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.150/2025, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga ankuesja A.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi të datës 06.01.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e kandidatit fitues për pozitën *Zyrtar i Skemave Pensionale* në Prishtinë.

A r s y e t i m

Ankuesja A.B. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 21.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 396/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00015584, për pozitën *Zyrtar i Skemave Pensionale* në Prishtinë, i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli më datë 04.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 396/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 21.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Konkursin me numër reference RN00015584 të datës 23.10.2024; Listën përfundimtare të vlerësimit; Vërtetimin e datës 25.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2025; Njoftimin e datës 06.01.2025; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin e datës 17.12.2024; Vendimin me Nr.574/2024 të datës 17.12.2024; Vendimin me Nr.574-1/2024 të datës 18.12.2024; Akt emërimit të datës 24.09.2024; Akt emërimit me Nr.119/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.113/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.112/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.126/2024 të datës 01.04.2024; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 01.03.2025 të ankueses dhe kandidatës; Aplikacionin e kandidatës L.B, të datës 18.11.2024 së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës, mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës; Aplikacionin e ankueses të datës 24.10.2024 së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës, mbi përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është ***e pabazuar, sepse:***

Nga analizimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 23.10.2024, ka shpallur Konkursin publik me numër Reference RN00015584, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Skemave Pensionale*” në Prishtinë, me afat për aplikimi nga data 24.10.2024 deri më datë 22.11.2024.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 223 kandidatë, ndërsa kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 137 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedure rekrutimi, ashtu që sipas listës përfundimtare të kandidatëve të datës 06.01.2025, është renditur e shtata në këtë listë me gjithsejtë 57.8 pikë të arritura, rrjedhimisht i kandidatë fituese ishte kandidatja L.B, e cila me gjithsejtë 91.6 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, sipas Njoftimit të datës 06.01.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, është shpallur kandidatë fituese për pozitën e punës *Zyrtar i Skemave Pensionale* në Prishtinë.

Ankuesja, e pa kënaqur me mos shpalljen kandidat fitues në këtë procedurë rekrutimi ka parashtruar ankesë në Këshill, duke theksuar se aplikon me dhjetëra hera në pozita të tilla mirëpo nuk është

shpallur kandidat fitues, dhe se po ashtu posedon përvojën relevante prej disa vitesh për këtë pozitë pune.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të ankesës së ankuesit, ju referuar legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht:

- Nenit 10, i cili përcakton se: *1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimin njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimin i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimin mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimin bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.*

Andaj, Kolegji I Këshillit, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe kuadrin ligjor të lartë theksuar, ka gjetur se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatët, nga rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidatja e përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, ku ankuesi në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh 57.8 pikë, ndërsa kandidatja L.B ka arritur 64.8 pikë nga faza e vlerësimit të testit me shkrim, dhe sikurse parashihet me dispozitat e Nenit 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, ankuesja si dhe kandidatja L.B kanë kaluar në fazën e vlerësimit të intervistës me gojë, nga e cila intervistë ankuesja ka arritur 14.8 pikë, dhe se bazuar në formularët e vlerësimit individual të kandidatëve të datës 03.01.2025, rezulton se I njëjti është vlerësuar në pajtim*

me dispozitat e sipër theksuara, sepse ka arritur pikë maksimale nga jetëshkrimi, ngase duke qenë se posedon diplomë të studimeve bachelor ka plotësuar kriterin arsimor dhe se po ashtu posedon përvojën profesionale pas studimeve themelore në sektorin publik, ashtu që me këtë rast nga provat e pranuar nga ankuesi si dhe nga organi i punësimit me asnjë dëshmi është vërtetuar ndonjë pargullësi procedurale apo shkelje ligjore gjatë kësaj procedure rekrutimi, për faktin se I njëjti ka arritur 72.6 pikë të përgjithshme, duku u renditur e shtata ndersa si kandidatues fituese L.B, e cila nga intervista me gojë ka arritur 26.8 pikë, duke arritur gjithsejtë 91.6 pikë,

Andaj, duke qenë kandidatja L.B, me rastin e aplikimit në këtë konkurs ka bashkangjitur Diplomën me Nr/28/19 të datës 29.01.2019, të lëshuar nga Kolegji Iliria, me të cilin dëshmon se me datë 24.06.2016, ka mbaruar studimet Programin Menaxhment dhe Informatikë, duke fituar kështu titullin Bachelor I Arteve në Menaxhmet dhe Informatik, Kolegji konstaton se e njëjta plotëson kriterin arsimor dhe po ashtu posedon përvojën një vjeçare profesionale pas diplomit të studimeve themelore, ngase sa i përket plotësimit të këtij kriteri e njëjta ka bashkangjitur Kontratën Nr.Ev.011 të datës 01.04.2014, mbi të cilën dëshmohet se e njëjta nga data 01.04.2018 deri më datë 30.06.2018, ka qenë e angazhuar në cilësinë e Agjentes së Shitjes; Kontratën e datës 25.09.2018, 06.04.2019 dhe 18.05.2020, me anë të cilave dëshmohet se nga data 25.09.2018 deri më datë 31.03.2021, kandidatja në fjalë ka qenë e angazhuar në cilësinë e Hulumtueses tek Instituti I Kosovës Demokrativ (KDI); Kontratat e datës 10.01.2022, 11.01.2023 dhe 12.01.2024, me anë të së cilave dëshmohet se e njëjta nga data 10.01.2022 deri më 12.01.2024 ka qenë e angazhuar si Koordinator e Projektit-Horeca EKSP, ndërsa pas kësaj date si Menaxhere në “HORECA”L.L.C, për të cilën përvojë pune e njëjta ka bashkangjitur edhe dëshminë mbështetëse apo pasqyrën e llogarisë së trustit, andaj duke qenë se ka plotësuar e kriteret përkatëse të konkursit si dhe ka arritur gjithsejtë 91.6 pikë, duke u renditur e para në listën e vlerësimit të kandidatëve, e njëjta ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidate fituese, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, I cili përcakton se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Duke u bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 06.01.2025, për kandidatin fitues për pozitën e punës *Zyrtar i Skemave Pensionale* në Prishtinë ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të

mbetet në fuqi Njoftimi mbi kandidatin fitues të datës 06.01.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore për pozitën “Zyrtar i Skemave Pensionale” në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.150/2025,

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.B;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasnsfereve; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së